



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/262  
Datë: 23/10/2020

Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datë 22.10.2020, bazuar në nenin 122 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, nenin 7 të Rregullores për studime të doktoratës, dhe Vendimit nr. 2/111 të datës 2.9.2016 për plotësim ndryshim të nenit 7, pikës 1 të paragrafit 4 të Rregullores për studimet e doktoratës nr. 1/775 të datës 9.9.2014 shpall:

## KONKURS

### *për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/21*

1. Universiteti i Prishtinës në studimet e doktoratës në vitin akademik 2020/2021 do të pranojë **134** studentë. Në 16 programe studimore në kuadër të gjashtë(6) fakulteteve.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12 %, përkatësisht deri **16** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

Fakulteti-Departamenti-Programi	Të rregullt	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti Filozofik</b>	4	1	5
Programi Histori	4	1	5
<b>FSHMN</b>	9	1	10
Programi Biologji e organizmave me ekologji	4	Përzgjedhja në diskrecion të Fakultetit, max. 1 kandidatë në njërin prej dy programeve	4
Programi Kimi	5		5
<b>Fakulteti i Filologjisë</b>	13	2	15
Programi Gjuhësi	9	1	10
Programi Letërsi	4	1	5
<b>Fakulteti Juridik</b>	18	5	23
Programi E Drejta Kushtetuese dhe Administrative	3	1	4
Programi E Drejta Ndërkombëtare	3	1	4
Programi E Drejta Civile	4	1	5
Programi E Drejta Penale	4	1	5
Programi E Drejta Financiare	4	1	5
<b>Fakulteti Ekonomik</b>	44	6	50
Programi Banka, Financa dhe Kontabilitet	13	2	15
Programi Menaxhment dhe Informatikë	13	2	15

Programi Marketing	9	1	10
Programi Ekonomiks ne gjuhen angleze	9	1	10
<b>Fakulteti i Mjekësisë</b>	<b>28</b>	<b>3</b>	<b>31</b>
Programi Biomjekësi Eksperimentale	3	0	3
Programi Shëndet Publik	3	0	3
Programi Mjekësi Paraklinike	4	1	5
Programi Mjekësi Klinike	9	1	10
Programi Stomatologji	9	1	10
<b>GJITHSEJ</b>	<b>118</b>	<b>16</b>	<b>134</b>

## I. KUSHTET E KONKURSIT

- (1) Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet në Fakultetet-Programet përkatëse.
- (2) Në studimet e doktoratës shkencore nuk mund të regjistrohen të diplomuarit në master profesional.
- (3) Kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
  - 3.1. Të diplomuarit para hyrjes në fuqi të studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës, të cilët duhet të jenë magjistra të shkencës përkatëse;
  - 3.2. Të diplomuarit pas hyrjes në fuqi të studimeve në bazë të deklaratës së Bolonjës – niveli i studimeve master shkencor;
  - 3.3. Të diplomuarit që kanë së paku 300 kredi European Credit Transfer System (ECTS);
  - 3.4. Kandidatët me notë mesatare jo më të ulët se 8.00 në secilin nivel të studimeve paraprake veç e veç; (Për t'u llogaritur e vlefshme nota mesatare 8.00 e më lartë në secilin nivel të studimeve, diplomat duhet të jenë të fituara së pari në nivelin baçelor e më pastaj në master).
  - 3.5. Kandidatët të cilët e kanë dëshminë për njohjen e një gjuhe të huaj botërore (anglisht, gjermanisht, frëngjisht ose gjuhë tjetër botërore) nga institucioni i autorizuar (fakulteti përkatës ose institucionet e akredituara).
- (4) Kriteret e vlerësimit të kandidatëve përfshijnë: suksesin në shkollim gjatë studimeve, interesin e treguar për kërkime shkencore/artistike, punimet e botuara, rekomandimet e dy profesorëve nga lëmi përkatës dhe propozimin e lëmit – fushës së hulumtimit. Intervista me kandidatin është obliguese, por nuk vlerësohet me pikë. Gjatë regjistrimit përcaktohen qartë të gjitha kushtet e domosdoshme për përfundimin e studimeve në kohën e paraparë.
- (5) Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitje përzgjedhëse janë:

5.1	<p>5.1.1. Nota mesatare gjatë studimeve themelore/baçelor dhe Master ka një vlerë maksimale prej 40 pikëve (që shpërndahet përpjesëtimisht: 20 pikë maksimale për notën mesatare në studime themelore dhe 20 pikë maksimale për notën mesatare në studime Master), të cilat pikë llogariten në mënyrën e përcaktuar si në pikën a), b), c) dhe d) të këtij paragrafi:</p> <p>Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitje përzgjedhëse janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) Nota mesatare gjatë studimeve themelore/baçelor është e barabartë me numrin e pikëve (p.sh.: nota mesatare 8.49 e barabartë me 8.49 pikë);</li> <li>b) Nota mesatare gjatë studimeve master ose ekuivalente me master është e barabartë me numrin e pikëve (p.sh.: nota mesatare 8.49 e barabartë me 8.49 pikë);</li> </ol>	<p><b>Pikët nga sukse si paraprak, punimet dhe aktivitetet shkencore max deri në 40 %.</b></p>
-----	---	--

	<p>c) Nota mesatare për studimet e përcaktuara si në pikën a) dhe b) të këtij paragrafi, shumëzohet me dy (p.sh. nota mesatare 8.49 x 2 e barabartë me 16.98 pikë).</p> <p>d) Programet studimore të cilat e kanë nivelin e parë dhe të dytë të integruar, nota mesatare e studimeve shumëzohet me katër (p.sh.: nota mesatare 8.49 x 4 e barabartë me 33.96 pikë);</p> <p>5.1.2 Magjistratura nga lëmi shkencor ose specializimi nga lëmi i ngushtë shkencor vlerësohet me 5 pikë (Sistemi i vjetër i shkollimit-magjistër i shkencave);</p> <p>5.1.3 Aktiviteti kërkimor – shkencor, siç dëshmohet me botimet dhe prezantimet si në vijim, vlerësohet me një vlerë maksimale deri në 35 pikë:</p> <p>a. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuar në <i>Current Contents</i>: autori i parë/korrespondent 5 pikë, të tjerët 2 pikë.</p> <p>b. Për çdo artikull të botuar në pesë vjetët e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara: autori i parë 3 pikë, të tjerët 1 pikë.</p> <p>c. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit në revista akademike vendëse, që botohen nga Universiteti i Prishtinës ose nga qendrat apo institutet e tij, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, nga Instituti Albanologjik dhe nga Instituti i Historisë, dhe që përdorin vlerësimin ose vlerësimin nga kolegët e fushës: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.</p> <p>d. Për libër universitar të botuar në pesë vjetët e fundit nga lëmi i ngushtë: autori ose bashkautori 5 pikë gjithsej.</p> <p>e. Për çdo prezantim gojor të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuara dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.</p> <p>f. Për çdo prezantim në formë afisheje të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuara dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.</p> <p>g. Për çdo prezantim gojor në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) shkencore me karakter vendës: autor i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.</p>	
5.2	<p><b>Provimi pranues:(me gjithsej 60%)</b></p> <p>Provimi pranues për të gjitha programet do të organizohet në fushën e studimeve përkatëse sipas specifikave të njësive akademike.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi pranues profesional:(<u>vlerësohet deri në 80 pikë maksimale</u>).</li> </ul> <p>5.2.1 <b>FAKULTETI FILOZOFIK</b></p> <p>a. <b><u>Programi Histori</u></b> – Kandidatët do t`i nënshtrohen provimit pranues për njohuritë Historia e përgjithshme Botërore dhe Historia e Popullit Shqiptar.</p> <p>b. 40 pikë nga provimi pranues.</p> <p>c. 20 pikë nga projekti hulumtues i prezantuar.</p>	<p><b>Pikët nga provimi pranues deri në 60%</b></p>

#### 5.2.2 FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

- a. Për programin Kimi, provimi pranues do të organizohet nga Kimia.
- b. Për programin Biologji e Organizmave dhe Ekologji, provimi pranues do të organizohet nga Biologjia.

#### 5.2.3 FAKULTETI I FILOLOGJISË

- a. Programi Gjuhësi, provimit pranues nga fusha e Gjuhësisë
- b. Programi: Letërsi, provimi pranues nga fusha e Letërsisë,

#### 5.2.4 FAKULTETI JURIDIK

- Provimi pranues do të mbahet nga këto lëndë:
  1. Programi Kushtetues dhe Administrativ:
    - a. E Drejta Kushtetuese
    - b. E Drejta Administrative
    - c. Fillet e së drejtës
  2. Programi E Drejta Ndërkombëtare:
    - a. E Drejta Ndërkombëtare Publike
    - b. E Drejta Ndërkombëtare Private
    - c. E Drejta Evropiane
  3. Programi E Drejta Civile:
    - a. E drejta Civile
    - b. E drejta e Detyrimeve
    - c. E drejta e Procedurës Civile
  4. Programi E Drejta Penale:
    - a. E Drejta Penale
    - b. E Drejta E Procedurës Penale
    - c. E Drejta e Ekzekutimit të Sanksioneve Penale
  5. Programi E Drejta Financiare:
    - a. Financa dhe e Drejta Financiare
    - b. E Drejta Tatimore Evropiane
    - c. Tregjet dhe Institucionet Financiare

Të drejtë konkurrimi kanë vetëm studentët që kanë përfunduar studimet *baçelor* dhe *master* në Fakultetin Juridik, respektivisht drejtimin - programin përkatës në nivelin e studimeve *master*.

Si kritere shtesë për pranim në programet e doktoratës në Fakultetin Juridik janë:

- (a) Kandidati/ja duhet të dorëzojë një kopje të punimit të *masterit*/magjistraturës, siç është dorëzuar apo protokolluar zyrtarisht në administratën e këtyre studimeve;
- (b) Kandidati/ja duhet të dorëzojë një projekt-propozim ideor origjinal përmes të cilit artikulon preferencën, vizionin dhe metodologjinë e tij/saj për zhvillimin e një projekti hulumtues në një fushë ose temë specifike të drejtimit përkatës. Në aspektin teknik, ky propozim duhet të paraqitet përmes një teksti prej më së shumti 10 faqeve të programit *word*, me madhësi shkronjash nr.12 dhe pa hapësira midis rreshtave.

Në rastin e kriterit të dytë shtesë (pika b më sipër), (i) kandidati/ja duhet të dëshmoj njohuri të thelluara nga literatura bashkëkohore në fushën ku ai/ajo konkurren për një pozitë në studimet e doktoratës. Ai/ajo duhet të jetë në gjendje ta bëjë të besueshëm guximin intelektual për të shfrytëzuar një bibliografi të gjerë të huaj e cila shkon përtej standardit lokal të hulumtimit shkencor, dhe (ii) kandidati/ja duhet të dëshmojë njohuri të thelluar të praktikës gjyqësore ndërkombëtare/të krahasuar në fushën ku ai/ajo konkurren të realizojë studimet e doktoratës. Njohuritë e tilla duhet të dëshmojnë si në aspekte formale ashtu edhe materiale të praktikës gjyqësore, me theks të veçantë tek praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo juridiksionet individuale shtetërore me peshë në të drejtën bashkëkohore.

#### 5.2.5 FAKULTETI EKONOMIK

Provimi pranues do të mbahet nga këto lëndë:

**1. Në programin: Banka dhe Financa**

- a) Financat e avancuara
- b) Financat e avancuara të korporatave
- c) Metoda kërkimore

**2. Në programin: Menaxhment dhe Informatikë**

- a) Teoritë e Menaxhmentit
- b) Menaxhimi i resurseve humane
- c) Metoda kërkimore

**3. Në programin: Marketing**

- a) Strategjitë e marketingut
- b) Sjellje konsumatore
- c) Metoda kërkimore

**4. Në programin: Ekonomiks- i akredituar për Gjuhë Angleze**

- d) Mikroekonomi e avancuar
- e) Makroekonomi e avancuar
- f) Statistikë dhe ekonometri

5. Provimi pranues do të organizohet edhe në gjuhën angleze.

6. Kandidatët të cilët posedojnë Certifikatë TOEFEL (Ose Ekuivalent me TOEFEL), me minimum 75 pikë nuk kanë nevojë të hyjnë në provim në gjuhë angleze.

#### 5.2.6 FAKULTETI I MJEKËSISË

- Programi Biomjekësi Eksperimentale;
- Programi Shëndet Publik;
- Programi Mjekësi Paraklinike;
- Programi Mjekësi Klinike;
- Programi Stomatologji

a. Provimi pranues do të organizohet në gjuhën angleze nga metodologjia kërkimore-shkencore e fushës së mjekësisë.

<p>(6) <b>Pragu i kalueshmërisë për të gjitha programet e studimeve të njësive akademike, është 50% i pikëve të akumuluar nga provimi pranues.</b></p>	
<p>(7) Njohuria e gjuhës angleze ose gjuhës së huaj botërore, relevante për fushën e studimit, deri në 20 pikë maksimale.</p>	
<p>(8) Në kushte të barabarta, përparësi i jepet kandidatit që është staf i rregullt i UP-së.</p>	

- (9) Senati i Universitetit, me propozimin e njësisë akademike dhe pas shqyrtimit në Këshillin qendror të studimeve të doktoratës, merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Emrat e kandidatëve të pranuar, me të gjitha të dhënat e kriterëve të përzgjedhjes, shpallen publikisht në ueb-faqen e njësive akademike dhe në ueb-faqen e Universitetit.
- (10) Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tre vjet, por, për shkaqe të arsyeshme, e për të cilat vendos Këshilli i studimeve të doktoratës, mund të vazhdojnë deri në pesë vjet. Për studentët që e kanë mbaruar magjistraturën shkencore dhe të cilët vazhdojnë studime të doktoratës në lëmin e njëjtë mund të transferojnë deri në 1/3 e numrit të përgjithshëm të kredive të parapara. Për transferimin e kredive vendos Këshilli i doktoratës i njësisë akademike, në bazë të kërkesës së kandidatit. Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga dita e regjistrimit, doktoranti e humb të drejtën për mbrojtje të punimit të doktoratës, përveç nëse Senati i UP-së, me propozim të KQSD-së dhe duke u bazuar në një arsyetim të dëshmuar të kandidatit, merr vendim tjetër. Nëse kandidatit i vazhdohet afati i kohëzgjatjes së studimeve, atëherë ndaj tij/saj do të aplikohen rregullat e përcaktuara sipas rregullores për studimet e doktoratës e cila është në fuqi në kohën e vazhdimit të kohëzgjatjes së diplomimit.
- (11) Kandidatët do t'i nënshtrohen testit në gjuhën angleze. Përjashtim do të bëhet vetëm për kandidatët të cilët posedojnë certifikatë TOEFL, IELTS.
- (12) Studimet e doktoratës, kanë statusin e studimeve të rregullta;
- (13) Kandidatët i nënshtrohen parimit të ndalimit të konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi, Kodit të Etikës dhe Udhëzuesit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit të Këshillit të Etikës në UP. Në mënyrë të veçantë, do të konstatohet që ekziston konflikti i interesit nëse kandidati/kandidatja ka në lidhje të drejtë gjaku një apo më shumë anëtarë të personelit akademik të njësisë akademike përkatëse.

## **II. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM**

- 1) Me rastin e aplikimit, kandidatët duhet t'i sjellin dokumentet origjinale si në vijim:
- a) certifikatën e lindjes (jo më të vjetër se gjashtë-6 muaj).
  - b) diplomën dhe certifikatën e notave (origjinale ose të noterizuara) nga nivelet e studimeve paraprake në studimet Bachelor, Master ose Magjistratura shkencore, ndërsa për Fakultetin e Mjekësisë diplomën dhe certifikatën e notave nga niveli i studimeve themelore (5-6 vjeçare);
  - c) kandidatët që kanë kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i nënshtrohen njohjes së diplomës më qëllim vazhdimi të studimeve duke ndjekur procedurën sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës,
  - d) një biografi me punimet shkencore të publikuara,
  - e) rekomandimet e dy profesorëve nga lëmi përkatës i hulumtimit.
  - f) fletëpagesën prej 2.5 eurosh (pagesa bëhet në bankë).

- 2) Paraqitja e dokumenteve të kompletuara në formë fizike bëhet në Fakultetet përkatëse. Të gjitha dokumentet e sipërshënuara në paragrafin 1 të kapitullit II të këtij konkursi duhet të dorëzohen edhe të kopjuara në CD.
- 3) Aplikimi elektronik bëhet në adresën: [apliko.uni-pr.edu](mailto:apliko.uni-pr.edu)
- 4) Komisioni pranues do të emërohet nga Këshilli i njësisë përkatëse akademike.

### III. AFATET E KONKURSIT

- a) Konkursi hapet nga data **02.11.2020** deri me **09.11.2020**.
- b) **Provimi pranues** mbahet me datë **12.11.2020** nga ora 10.00, informata shtesë për sallat e mbajtjes së provimit pranues, do të publikohen më vonë në ueb faqe të fakultetit përkatës.
- c) **Intervista** me kandidatë do të mbahet me datë **16.11.2020** dhe **17.11.2020** nga ora 10.00.
- d) **Rezultati preliminar** do të shpallet me datë **18.11.2020 deri në ora 15:30**.
- e) Ankesat e kandidatëve të papranuar do të pranohen me datën **19.11.2020** dhe **20.11.2020** deri në ora 15:30. Vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga Komisioni për studime të doktoratës i njësisë akademike përkatëse, më së largu deri më datë **25.11.2020**.
- f) **Rezultati përfundimtar** Senati i Universitetit, me propozimin e njësisë akademike dhe pas shqyrtimit në Këshillin qendror të studimeve të doktoratës, merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Emrat e kandidatëve të pranuar, me të gjitha të dhënat e kriterëve të përzgjedhjes, shpallen publikisht në uebfaqen e njësisë akademike dhe në ueb faqen e Universitetit.
- g) **Data e regjistrimit** të kandidatëve të pranuar do të publikohet pas vendimit përfundimtar të Senatit.

Studimet e doktoratës për studentët e regjistruar në vitin akademik 2020-21 do të realizohen në përputhje me Rregulloren në fuqi të miratuar nga Senati me vendimin nr. 1/775 të datës 09. 09. 2014 dhe Vendimit nr.2/111 të datës 2.9.2016 për plotësim ndryshim të nenit 7, alinesë 1 të paragrafit 4 të Rregullores bazike nr. 1/775 të datës 09. 9. 2014. Punimet shkencore të nevojshme për mbrojtje të disertacionit duhet të jenë në platformat e përcaktuara nga Senati.

